



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 71, Datë 12.04.2024

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “WENERG” SH.A. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT TË ERE-S PËR VENDOSJEN E BARRËS SIGURUESE TË RADHËS SË DYTË MBI AKSIONET E SAJ SI PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 9, pika 8 dhe nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 185/4 prot., datë 09.04.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “WEnerg” sh.a. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e barrës siguroese të radhës së dytë mbi aksionet e saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “WEnerg” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 51, datë 05.07.2010, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 137, datë 08.10.2012.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 185 prot., datë 18.01.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për vendosjen barrës siguroese të radhës së dytë mbi aksionet e shoqërisë “WEnerg” sh.a. nga “YLLIAD” sh.p.k. në favor të CN’AIR, kjo si garanci për pagesën e Shtesës së Çmimit 1 dhe Shtesës së Çmimit 2, referuar përcaktimeve të Marrëveshjes për shitblerjen e aksioneve të shoqërisë “WEnerg” sh.a., nënshkruar më 01.06.2023, mes “YLLIAD” sh.p.k. dhe “CN’AIR”.

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 238, datë 21.12.2020, është vendosur dhënia e autorizimit nga ERE për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “WEnerg” sh.a., në favor të “BANKËS OTP ALBANIA” sh.a. (ish-Societe Generale Albania sh.a.).
- Në lidhje me këtë barrësim, shoqëria ka depozituar në ERE Deklaratën Noteriale të datës 29.03.2024, me anë të së cilës “BANKA OTP ALBANIA” sh.a., në cilësinë si barrëmarrëse e radhës së parë mbi aksionet e shoqërisë “WEnerg” sh.a. jep pëlqimin e saj për vendosjen e barrës siguroese të radhës së dytë në favor të CN’AIR, me kushtin që kjo barrë të fshihet në momentin e plotësimit të kushteve të parashikuara në Kontratën e Cedimit mes palëve.
- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria, me shkresën e ERE-s nr. 185/1 prot., datë 02.02.2024, i është evidentuar shoqërisë informacioni/dokumentacioni i munguar i këtij aplikimi. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 185/2 prot., datë 20.02.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Duke qenë se kishte ende dokumentacion të paplotësuar, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 185/3 prot., datë 13.03.2024. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 185/4 prot., datë 02.04.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e munguar të aplikimit.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pika 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si dhe rezulton se ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e aksioneve të shoqërisë “WEnerg” sh.a. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi aksionet për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi aksionet ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e barrës siguroese të radhës së dytë mbi aksionet e shoqërisë “WEnerg” sh.a. në favor të “CN’AIR”.
2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Wenerg” sh.a. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “WEnerg” sh.a. duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi aksionet ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “WEnerg” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI